



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-22-0545**

***Në ankesën e***

***Paditësi***

**N Sh**, Gjilan.

***kundër***

***E paditura/Ankuesja***

**NSH "Agrokultura"**, (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Ganimete Puka gjyqtar, duke vendosur sipas ankesës e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-3140 të datës 08 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 qershor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-3140 i datës 08 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 24 prill 2014, paditësi përmes postës e dërgoj në DHPGJS një ankesë të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI004-0495 të datës 21 mars 2014, me të cilin kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 396.00 euro për periudhën maj - korrik 2006, është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se paditësi nuk ka dorëzuar prova që brenda 3 viteve ti ketë kërkuar këto paga pranë Gjykatës kompetente. Paditësi në ankesë i konteston si të pa bazuara këto konstatime të dhëna nga ana e Autoritetit të Likuidimit. Paditësi pohon se ndihet i tradhtuar kur është larguar nga vendi i tij i punës pasi që ish drejtori i NSH-së na ka premtuar se me fillimin e procedurës së likuidimit ai do ti merr gjashtë paga të pa paguara. Bashkë me ankesë ka dorëzuar Listën e pagave të pa paguara të punëtorëve në të cilën listë paditësi është në numrin rendor 45.

Me datë 03 korrik 2014, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS, duke i përsëritur të njëjtat pretendime që i ka cekur në ankesë. Me këtë parashtresë përsëri e dorëzon listën e punëtorëve për pagat e pa paguara.

Me datë 12 nëntor 2021, Shkalla e I-rë e lëshon një urdhër për paditësi me të cilën ka kërkuar ta dorëzojë ankesën e nënshkruar si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 22 nëntor 2021, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS, si përgjigje ndaj urdhrit me të cilën e ka dërguar ankesën e nënshkruar si dhe vendimin e ankmuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 29 dhjetor 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit e ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa për paga për periudhën e kërkuar maj - korrik 2006, është kërkesë e parashkruar pasi që paditësi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor brenda 3 viteve nga korriku 2006, kur ai pretendon se nuk i ka

realizuar pagat nga NSH-ja. Tutje AKP-ja pohon se afati i parashkrimit që ka ndodhë nuk i lejon Autoritetit të Likuidimit ta analizoj dhe shqyrtoj meritat e rastit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Me datë 08 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-3140, e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe e detyron të paditurën ti paguaj paditësit pagat në shumë prej 194.20 euro për periudhën maj - korrik 2006, e cila pagesë do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësi ishte një punëtor i NSH KBI "Agrokultura", por kontestuese mbetet çështja e parashkrimit të kërkesës për pagat e pa paguara. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të listës së pagave për muajin maj, qershor dhe korrik 2006 NSH-ja paditësit i ka mbetur borxh në shumë prej 194.20 euro, andaj ketë listë e pranon si provë relevante për të ardhur në përfundim se paditësi ka ofruar shërbime punë për NSH-në, por që pagat nuk janë paguar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se e paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën për të provuar faktin se ankuesi nuk ishte ofruar shërbime punë për NSH-në, andaj kërkesa nuk mund të konsiderohet e parashkruar.

Me datë 22 shtator 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një ankesë kundër aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-3140, të datës 08 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit, dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në ankesë, AKP-ja ka pohuar se gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizoj në Gjykatë e që është afati i aplikueshëm i parashkrimit i bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërprënë parashkrimit, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të

drejtën të parashtroj kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. Tutje AKP-ja e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar. Në ankesë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e shkallës së I-rë dhe të II-të të DHPGJS-së.

Me datë 20 dhjetor 2023, paditësi e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pabazuara në ligj, ndërsa e mbështet Aktgjykimin e ankimuar, duke pohuar se është vendosur drejtë në bazë të ligjit. Paditësi në këtë parashtresë e kundërshton konstatimin e AKP-së se kërkesa është parashkruar. Në këtë parashtresë paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 06 janar 2014, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit, një kërkesë për pagesën e pagave të papaguara nga NSH "Agrokultura" (në likuidim), për periudhën maj - korrik 2006, në shumë prej 396.00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pavlefshme nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar.

Kolegji i Apelit mbështet në tërësi konstatimin e Shkallës së I-rë, se kërkesa për paga për periudhën maj - korrik 2006, nuk është parashkruar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkalën e I-rë ka dorëzuar Listën e pagave të pa paguara të punëtorëve të NSH-së KBI "Agrokultura" (në likuidim) të datës 31.07.2006, sipas së cilës listë paditësi është në numrin rendor 45.

Shkalla e I-rë me të drejtë e ka marrë si provë listën e cekur të pagave, pasi që ajo është hartuar nga kompetentët e NSH-së dhe vërteton që NSH-ja u ka mbetur borxh punëtorëve për pagat e pa paguara deri me 31 korrik 2006. Kjo listë nënkupton se paditësi deri në këtë periudhë ka ofruar shërbime punë për NSH-në, andaj NSH-ja ka përgatitur listën që vërteton ekzistimin e borxhit.

Andaj duke u bazuar në provën që e ka sjellë paditësi në gjykatë me të drejtë Shkalla e I-rë e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për paga në shumë prej 194.20 euro, e cila do të paguhet nga AKP-ja në procedurën e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar, dhe vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore:**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, me datë 11 tetor 2022, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 20 qershor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues \_\_\_\_\_